

Data 18.01.2019

Në bazë të Marrëveshjes Bashkëpunimi me datë 17.01.2019, në mes të OZHR "Mëshqerra" dhe Komunës së Shtimes për ndarjen e Mëshqerrave për fermer, OZHR "Mëshqerra" shpall:

THIRRJE PUBLIK

OZHR "Mëshqerra" dhe Komuna e Shtimes kanë marrëveshje që të realizojnë një projekt të përbashkët në lëmin e blegtorisë për fermerët e Komunës së Shtimes. Projekti do të zgjas 2 vite (2019-2020), dhe do të përfshijë një kontingjent prej 29 krerëve të Mëshqerrave barrëse të racës Hollshtajn-Frizis (për 29 familje), si me impute të tjera bazike blegtorale-bujqësore dhe trajnime të nevojshme për këta fermerë.

KRITERET PËR PËRFITIMIN E NJË MËSHQERRE

1. Fermerët që posedojnë ferma adekuate që i plotësojnë standardet sipas mirëqenies së kafshëve për lopë qumështore.
2. Fermerët që momentalisht kanë në mbarështim 1 deri 4 lopë qumështore.
3. Përfituesi duhet të participojë në pjesëmarrje në projekt me 400€ (katërqind euro)
4. Fermeri që ka më shumë se 1 ha tokë të punueshme bujqësore.
5. Fermeri që shpreh gatishmëri të nënshkruaj kontratën me donatorët dhe të përmbush obligimet që dalin nga kontrata, sidomos foto familjare me mëshqerrën (kërkesë nga donatori)
6. Të ketë sasi të mjaftueshme të ushqimit për kafshë të deponuar.
7. Përparësi kanë fermerët që burim primar të ekzistencës e kanë bujqësinë.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Vërtetimi i tatimit në pronë (obligimi për tatimin në pronë deri në vitin 2018 duhet të jetë 0);
3. Fleta poseduese për patundshmërisë;
4. Numri identifikues i fermerit (NIF);
5. Kopjen e listës së verifikimit të gjedheve të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së.

Afati për aplikim nga data 18.01.2019 deri më 28.01.2019.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e bujqësisë (objekti i komunës së Shtimes).

Vërejtje: Aplikuesi duhet të jetë banor rezident i Komunës së Shtimes. Përparësi kanë individët që nuk kanë qenë përfutës të ndo një subvencioni nga komuna apo Ministrit në vitin 2018, përparësi kanë individët që të ardhurat primare i kanë nga bujqësia

OZHR "Mëshqerra" Prishtinë

Florentina Kida Gërguri, Drejtore

F. Kida

